



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 482/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Ferit Osmani Kryesues i panelit, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Anr. 482/2010 datë 16.12.2010, për shkak se nuk korrespondon numri i vendimit me numrin e ankesës, me datën 28.12.2010 mori kete;

V E N D I M

PËRMIRSOHET vendimi i PZAP-it, Anr. 482/2010 i dt. 16.12.2010 dhe atë në reshtin e parë të arsyetimit ashtu që në vend të fjalisë “PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik FER” **duhet të jetë PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik PDK.** Pjesët tjera të këtij vendimi mbesin të pandryshuara.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një kërkesë nga subjekti politik LVV më Anr. 670/2010 datë 17.12.2009, më të cilën ka kërkuar korrigjimin e vendimit Anr. 482/2010 datë 16.12.2010 me propozim për dhënien e vendimit sipas përmbajtjes së ankesës.

PZAP-i, pas vlerësimit të kërkesës dhe propozimit të palës ankuese, shikimit të vendimit e lartëcekur, ka konstatuar se gjatë përpilimit të vendimit Anr. 482/2010 datë 16.12.2010, është bërë gabim teknike, sa i përket fjalisë: “PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik FER” duhet të jetë PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik PDK.

Andaj duke marrë parasysh një lëshim të tillë, PZAP-i ka marrë vendim si në dispozitiv, konform nenit 165.1 të LPK në lidhje me nenin 165.3 të LPK.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 482/2010 datë 28.12.2010

